



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM Nr.69

Datë 22/12/2023

**“ MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFAT-MESËM 2024-2026
DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË VORË PËR VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Vorë i mbledhur sot më datë 22/12/2023 Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, pikës 17, të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr.8 datë 28.02.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024 - 2026”, udhëzimit plotësues nr.23 datë 08.07.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Buxhetor 2024-2026 dhe Detajimin e Buxheti të Bashkisë Vorë për vitin 2024 sipas dokumentit bashkëlidhur.



2. Të Miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Vorë 478 punonjës bashkë me Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxullë.sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Sektori i Administratës,Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Shërbimeve Publike, Sektori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sektori i Financës, Sektori i Taksave dhe Tarifave, Sektori i Bujqësisë, Sektori i Pronave, Sektori Emergjencave Civile dhe Sektori i Ndihmës Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura.

KRYETARE E KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





05.01.20

61

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 690/Prot.

Lënda: Verifikim Ligjshmërie.

Tiranë më 4.1.2024

KËSHILLIT TË BASHKISË VORË

Bazuar në Ligjin nr.107/2016 «Për Prefektin e Qarkut», neni 8, gërma a, neni 16, gërma 2/a, dhe Ligjin nr. 139/2015 «Për vetëqeverisjen Vendore», Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr 68-72, datë 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak Vorë.

Vendimi nr.68, datë 22.12.2023 «Për propozimin për dhënien e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për familjet në nevojë për muajin nëntor 2023»,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 «Për vetëqeverisjen vendore», Ligjin nr. 57/2019 «Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë», si dhe VKM-së nr.597, datë 04.09.2019 «Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike», i ndryshuar».

Vendimi nr.69, datë 22.12.2023 «Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2024»,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 «Për vetëqeverisjen Vendore», i ndryshuar, Ligjit me nr 9936, dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» si dhe Ligjit nr. 68/2017 «Për financat e vetëqeverisjes vendore».

Vendimi nr.70, datë 22.12.2023 «Për miratimin e dhënies së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional»

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 «Për vetëqeverisjen Vendore» i ndryshuar, VKM-së nr 666/2019 «Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike».

Vendimi nr.71, datë 22.12.2023 «Për miratimin e dhënies së bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike parauniversitare për vitin shkollor 2023-2024»,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 « Për vetëqeverisjen Vendore » i ndryshuar, VKM-së nr 666/2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”.

Vendimi nr.72, datë 212.12.2023 «Për miratimin miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027»,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 « Për vetëqeverisjen Vendore » i ndryshuar, Ligjit me 9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» si dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

PREFEKT

AFRIM QËNDRO

